

## Koment

### Afati 5 vjeçar për të bërë një vlerësim tatimor.

Ne lidhje me afatin 5 vjeçar për të bërë një vlerësim tatimor, ndonjë ligji e ka shumë të qarta dhe të sakta, përndryshe ka disa raste që tentohet të interpretohet sipas rrethanave dhe në mënyrë shumë absurde.

Një rast i tillë është dhe vetë Drejtoria e Apelimit Tatimor të cilin do e trajtojmë më poshtë.

Ne ligjin 9920 dt.19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në R.Sh.” nenin 73 pika 1 theksohet se:

“E drejta e administratës tatimore **për të bërë një vlerësim tatimor parashkruhet brenda 5 vjetëve, nga data e fundit e dorëzimit të deklaratës tatimore**, të përcaktuar në legjislacionin tatimor përkatës”.

Pra, psh. deklarata e fundit e dorëzuar për vitin 2010, është në 31.3.2011

- Viti i 1-re 31.3.2012
- Viti i 2-te 31.3.2013
- Viti i 3-te 31.3.2014
- Viti i 4-te 31.3.2015
- Viti i 5-te 31.3.2016

Nga sa më sipër

1. Në ligj përcaktohet se merret parasysh data e fundit e deklaratës tatimore të dorëzuar që është deklarata e tatimit të bilancit **pra data 31 mars 2011**
2. Në ligj përcaktohet se, brenda 5 vjetëve **pra brenda datës 31 mars 2016**
3. Në ligj përcaktohet se, **për të bërë vlerësim tatimor dhe jo për të filluar kontrollin tatimor.**

E themë me fjale të tjera, Kontrolli tatimor mund të fillojë kur të dojë dhe të vazhdojë sa të dojë (gjithmone brenda kuadrit ligjor), por, por, por, Njoftimi Vlerësimi Tatimor nuk mund të nxirret pas datës 31 Mars 2016 për vitin 2010.

Ligji nr.9228 dt.29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, Neni 17, Ruajtja e dokumentave përcakton se, dokumentat ruhen për 10 vjet.

Nga ky këndvështrim, kontrolli mund të bëhet për të gjitha vitet që ruhen dokumentat, por, por, por, Njoftimi Vlerësimi Tatimor nuk mund të nxirret më 5 vjet.

Per sa trajtuam ne pjesen hyrese te ketij komenti, ne disponojme nje vendim te Drejtorise se Apelimit Tatimor, ne te cilin, jo vetem nuk e zbatohet kerkesa e ligjit, por e ngaterron ate.

Po citojme kete arsyetim :

*“Drejtoria e Apelimit Tatimor vlereson se kontrolli eshte kryer ne subjekt **mbi bazen e dokumentacionit te ofruar nga vete shoqeria**. Shoqeria ne ankimim ka pretenduar se kjo periudhe eshte jashte afatit 5 vjeçar te parashkruar nga neni 73 i procedurave dhe nuk ka pretendim tjeter. **Por bazuar ne praktiken e ndjekur ne vijimesi nga Drejtoria e Apelimit Tatimor koha e percaktimit te afatit lidhet me daten e Lajmerim Kontrollit.**”*

Mbi kete baze ne kemi te drejten te pyesim:

Kur Drejtoria e Apelimit Tatimor, si organ gjykimi, e interpreton keq, apo me keq akoma, e shkel ligjin, çfare mund te presesh nga inspektorët e kontrollit neper Drejtorite Rajonale???

Lusim Zotin ta kemi ne gabim ose e kunderta Lusim Zotin te mos keni me raste te tilla.